

V E N D I M
Nr.232, datë 21.8.2001

**PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË KOALICIONIT POLITIK “BASHKIMI
PËR FITORE”, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

OBJEKT: Për shpalljen e listës së deputetëve të koalicionit politik “Bashkimi për Fitore”, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

BAZA LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur.

KONSTATOI SE:

Koalicioni politik “Bashkimi për Fitore”, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumemërore të këtij koalicioni. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.794, datë 4.6.2001 “Për rregjistrimin e listës shumemërore të koalicionit “Bashkimi për Fitore” për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001”.

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë të cilët i përkasin një partie apo koalicioni të partive, në bazë të përqindjes që koalicioni “Bashkimi për Fitore” ka marrë zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet që ky koalicion të marrë 21 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 21.

Koalicioni Bashkimi për Fitore, me shkresën nr.8913, prot, datë 29.7.2001, ka vënë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për dorëheqjen që kandidati i këtij koalicioni z. Abaz Ermenji, përfaqësues i subjektit politik të Ballit Kombëtar, ka dhënë dorëheqjen nga kandidimi për deputet nga lista shumemërore e këtij koalicioni.

Në bazë të marrëveshjes së koalicionit të depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në listën shumemërore të koalicionit, kandidatët me numër rendor 5, 9, 13, 17 dhe 32 janë kandidatë të Partisë Balli Kombëtar. Meqenëse kandidati i kësaj partie ka dhënë dorëheqjen dhe në bazë të marrëveshjes ky vend i takon sërishmi Partisë Balli Kombëtar, përfaqësuesit e koalicionit kanë propozuar që në listën shumemërore të bëhen këto ndryshime:

Kandidati Shpëtim Rroqi nga numri rendor 9 kalon në numrin rendor 5;
Kandidati Uran Metko nga numri rendor 13 kalon në numrin rendor 9;
Kandidati Alfred Çako nga numri rendor 17 kalon në numrin rendor 13;
Kandidati Luan Myftiu nga numri rendor 32 kalon në numrin rendor 17.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura, çmon se meqenëse sipas marrëveshjes së koalicionit, të gjitha këto ndryshime kanë të bëjnë dhe i përkasin vetëm Partisë Balli Kombëtar, atëherë ato mund të pranohen.

Gjithashtu, lista shumemërore e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk do të llogariten në ndarjen e mandateve plotësuese kandidatët të cilët janë shpallur fitues në zonat zgjedhore njëmërore.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të shpallë listën e deputetëve të koalicionit politik “Bashkimi për Fitore” të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001 si vijon:

1. Ridvan Bode
2. Eqerem Spahiu
3. Fatmir Mediu
4. Shpëtim Rroqi
5. Jemin Gjana
6. Maksim Begeja
7. Uran Metko
8. Teodor Laço
9. Aleksandër Garuli
10. Alfred Çako
11. Bahri Kollcaku
12. Et’hem Fezollari
13. Robert Çeku
14. Luan Myftiu
15. Fatos Beja
16. Neritan Alibali
17. Sadedin Balla
18. Ilir Bano
19. Arjan Starova
20. Sokol Olldashi
21. Marjeta Pronjari

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari
Gaspër Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi